



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE  
Drejtoria Rajonale Tatimore Fier

Nr 8834 Prot.

Date 10.06.2014

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr.Regj. Themeltar 1704

Date 17.03.2014

Nr.1692 Vendimi

Date 12.05.2014

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata Administrative e Apelit e perbere nga gjyqtaret :

KRYESUES : ARTUR MALAJ

ANETARE : LINDITA SINANAJ

ANETARE : ALTINA NASUFI

asistuar nga sekretare gjyqesore Ermelinda Nuraj, ne dhome keshillimi te dates 12.05.2014, mori ne shqyrtim çeshjen qe u perket paleve :

PADITES : Shoqeria “JoeLa Cuko” Sh.p.k, perfaqesuar nga perfaqesuesi ligjor Thanas Cuko, me adrese, Mbrostar, Ura fshati Mbrostar, Fier

E PADITUR : Drejtoria Rajonale Tatimore Fier Lagja Apollonia Rruga e Semanit Fier  
Drejtoria e pergjithshme e Tatimeve (Drejtoria e Apelimit Tatimor) me adrese Rruga Gjin Bue Shpata prane Stadiumit Dinamo Tirane

OBJEKTI : Konstatim i pavlefshmerise absolute i aktit administrative njoftimit vleresimi per detyrimet tatimore" nr prot nr.7278/5 date 29.08.2013 , lene ne fuqi me Vendimit te Drejtorise se Apelimit Tatimor nr. 17099/1 Prot. date 15.11.2013 duke shfuqizuar kete akt dhe duke zgjidhur pasojat anulimin e gjobes.

BAZA LIGJORE : Nenet 324, 329, 331 te K.Pr.Civile, Neni 7 i ligjit nr.49/2012

Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative, nenet 116/b/c e 138 te K.Pr.Administrative, neni 80 vijim i Ligjit nr.9920, date 19.05.2008, "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise, Udhezimi nr. 17 date 13.05.2012 "Per TVSH" i ndryshuar.

**Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore me vendimin nr. 80 , date 03.02.2014 ka vendosur:**

- 1- Rrezimin e kerkesepadise si te pabazuar ne prova dhe ne ligj.
- 2- Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te paditesit.

**Kunder vendimit nr. 80 , date 03.02.2014 te Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore ka paraqitur ankim pala paditese Shoqeria " Joela Cuko" sh.p.k qe kerkon prishjen e vendimit nr. 80 , date 03.02.2014 te Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore, duke gjykuar ceshtjen te konstatoje pavlefshmerise absolute te aktit administrativ njoftimit vleresimi per detyrimet tatimore: nr. prot nr. 7278/5 date 29.08.2013, lene ne fuqi me Vendimet te Drejtorise se Apelimit Tatimor nr. 17099/1 Prot, date 15.11.2013 duke shfuqizuar kete akt dhe duke zgjidhur pasojat e anullimit te gjobes, duke parashtuar keto shkaqe :**

- Per te vendosur rrezimin e padise sone gjykata i eshte referuar ne arsyetimin e saj shkresave te prokurorise sipas te cilave rezulton se "subjekti "Dielli"sh.p.k me nuk ka shitur ne te vertete mallra sipas faturave pasi ka qene vetem nje shoqeri fantazem. Te njeten gje pohon edhe pala e paditur Drejtoria e Apelimit Tatimor.
- Keto shkresa te prokurorise dhe pales se paditur gjykata i ka administruar si prove dhe i ka vendosur ne themel te arsyetimit te saj. Eshte jashte cdo diskutimi se nuk kane asnje fuqi provuese shkresat e prokurorise dhe ato te pales se paditur qe paraqit pretendime para gjykates. Prokuroria eshte organ i ndjekjes penale dhe paraqet dhe mborn akuzen para gjykates dhe vetem nese jemi para nje vendimi gjyqesor te fomes se prere mund te shtrohet ne diskutim fuqia provuese e tij qe rregullohet nga dispozitat e KPP.

- Ne te kundert nga sa pranon gjykata ne arsyetimin e saj nga sa kemi pretenduar para gjykates ka rezultuar e provuar se: Ne kontrollin e blerjeve te vitit 2012 per periudhen Mars-Prill 2012 nga ana e Subjektit Joela Quko Sh.p.k jane kryer blerje nga Subjekti tregetar Deilli-B per artikullin Lende Drusore ne sasine 480 m<sup>3</sup> dhe ne vlere 9.400.000 leke. Ne raport permendet fakti se nga Drejtoria Rajonale Kukes ka rezultuar se shoqeria Dielli-B ka leshuar fatura fiktive te pashoqeruara me mall per shumen prej 9.400.000 leke dhe kjo ka sjelle nje kreditim te padrejte te TVSH-se per subjektin " Joela Quko" sh.p.k ne shumen e tvsh-se 1.880.000 leke. Kjo ka rezultuar edhe nga raportet e marra e TAXRM rajonale Kukes ku subjekti tregetar Dielli-B nuk ka te deklaruar blerje per kete periudhe dhe nuk ka si te kete shitje per kete periudhe per te trete. Sa me siper nga ana e organeve te prokurorise ndaj kesaj shoqerie ka filluar edhe Procedimi Penal.
  
- Pra sa me siper ndoshta ky subjekt e ka ushtruar aktivitetin e tij tregetar ne kundershtim me dispozitat ligjore por une si subjekt tregetar per kete periudhe tatimore per transakcionet tregetare me subjektin Dielli-sh.p.k kam bere deklarime te rregullta te shitjeve, blerjeve, tvsh-se me formatin e rregullt te fatures tatimore konform ligjit per TVSh-ne per kete sasi lende drusore. Ne baze edhe te bilanceve te dorezuara prane drejtorise tatimore fier ku kam dale me teprice kreditore prej 1.880.000 leke. Po keshtu ne vazhdim te Raportit te kontrollit Inspektoriatit shprehet se " Nga kontrolli i bilancit te subjektit Joela Quko sh.p.k rezulton se i ka pasqyruar edhe ne shitje blerjet per periudhen e vitit 2013 ne artikullin lende drusore dhe ka llogaritur shtese vlere per blerjet sipas analizes se shteses se vleres te kryer edhe me poshte. Edhe pse nga ana e inspektorit te kontrollit shprehet se vlere eshte me poshte ajo nuk eshte e pasqyruar megjithate ju bej me dije se per sasine prej 480 m<sup>2</sup> Derrase eshte kryer shitja e cila kap vleren prej 12.365.000 leke me TVSH ne shumen 2.475.000 leke pra me diference mbi blerjet e realizuara ne shumen 595.000 leke TVSH ne blerje 1.880.000 leke-t.v.sh ne shitje 2.475.000 leke. Ne kete menyre rezulton se shoqeria jone nuk mund te bjere dakort me penalizimin e bere ne Raport Kontroll duke me denuar vetem per blerjet po per shitjet?
  
- Nje problem tjeter eshte edhe penalizimi per tatimin mbi fitimin ne shumen 940.000 leke ( blerje 9.400.000 leke x 10%) ku nuk jemi absolutisht dakort pasi shitjet i kemi pasqyruar dhe kemi rakorduar pasi ne bilacin material dalim te barabarte me inventarin fizik te kryer. Ne te ardhurat e vitit 2012 keto blerje jane pasqyruar ne vlere jo me 9.400.000 leke por ne

vleren 12.365.000 leke me difference prej 2965.000 leke. Sa me siper nuk mund te paguhet dy here tatim mbi fitimin mbi te njejtën sasi të cilën e kam blerë dhe shitur sa me siper duke paguar tatim fitimi mbi fitimin real që kam realizuar nga diferenca ndërmjet blerjes dhe shitjes së këtij artikulli.

- Në analizë të sa me siper nuk jam absolutisht dakort me penalizimin që më është dhënë mbi TVSh- të padeklaruar se bashku me kamat vonese dhe gjoha plus edhe tatimin mbi fitimin e padeklaruar të cilat në total shkojnë në vlerën prej 3.666.870 leke.
- Gjendjes kreditore të TVSH-se e subjektit Joela Quko sh.p.k si pasoje e transaksioneve tregëtare me shoqërinë DIELLI është përlogaritur edhe në deklaratimet e mëvonshme pra pas periudhës mars-prill 2012 me subjekte të tjera tregëtare ku janë bërë edhe veprimet financiare perkatese të bazuara edhe në bilancin e dorëzuar konform të gjitha kërkesave ligjore. Bilanc ky tashmë i miratuar edhe nga Drejtoria e Tatimeve Fier. Sa me siper konkluzioni i arritur nga ana e Inspektoreve Tatimor pasqyruar në raportin perfundimtar të kontrollit nuk i përgjigjet aspak rakordimit të veprimeve financiare dhe gjendjes reale financiare të subjektit Joela Quko sh.p.k duke sjell si rezultat në një vendim marrje të gabuar dhe në kundërshtim flagrant me ligjin. Konkretisht nga ana e grupit të Inspektoreve të kontrollit nga pikpamja formale dhe procedurale ky akt është korrekt dhe është në përputhje me ligjin por në konstatimet e kryera nga inspektoret është në kundërshtim me ligjin mbi procedurat tatimore nën 80 i ligjit nr.9920 “Për procedurat Tatimore” konstatimi i pasqyruar në faqen 5 të aktit të kontrollit ku shprehimisht citohet se “Nga kontrolli i bilancit material subjekti Joela Quko sh.p.k rezultoi se i ka pasqyruar edhe në shitje blerjet për periudhën e vitit 2012 në artikullin Lende Druri Derrase dhe ka llogaritur shtesë vlerë vetëm për blerjet sipas analizës së shtesës së vlerës të kryer me poshtë”.
- Këtë ndalet ky konstatim duke mos analizuar me tej gjendjen e TVSH-se për periudhën në të cilën është ushtruar kontrolli. Sa me siper arrijmë në konkluzionin se si pasoje e këtij konstatimit të gabuar është arritur edhe në një vendimarrje të gabuar duke nxjerrë një akt administrativ konkretisht “njohfimit vleresimi për detyrimet tatimore” nr prot nr.7278/5 date 29.08.2013, lënë në fuqi me Vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor nr. 17099/1 Prot. date 15.11.2013.. i cili në kuptim të nenit 116/c të Kodit të Procedurave Administrative klasifikohet si akt absolutisht i pavlefshëm. Bazuar në nenin 116/c ky akt nuk është xjerrë

ne formen dhe proceduren e kerkuar nga ligji pasi eshte nje shkelje e paster e ligjit per TVSH-ne dhe ligjit per "Procedurat Tatimore nr 9920 date e per pasoje si akt absolutisht i pavlefshem ai nuk mund te sjelle pasoja e deshuruara per palet. Pra nje Akt administrativ absolutisht i pavlefshem per shkak te shkeljes thelbesore te ligjit nuk ka fuqine juridike te nje akti te vlefshem. Ai qe ne momentin e nxjerrjes se tij nuk krijon dhe as nuk mund te krijojte pasojat juridike per te cilat eshte nxjerre. Nje akt i tille nuk ka fuqi detyruese ndaj personave apo subjekteve, te cileve u drejtohet dhe, per rrjedhoje, keta ose gdo organ tjetër mund te kundërshtojë drejtperdrejt plotesimin e detyrimeve apo urdherimeve qe rrjedhin prej tij.

- Pra e thene me thjesht ne gjithë kronogjine e parashtruar me siper ne baze te kesaj procedure une si subjeket jo vetem, qe nuk i kame krijuar dem shtetit por perkundrazi shteti ka perfitur nga aktiviteti i shoqerise sime si tatim fitimin dhe vleren e TVSH. Te gjitha keto veperime gjejne pasyqrim ne ne bilancin e shoqerise i cili eshte i miratuar nga shoqeria dhe gjithashtu edhe nga vete pala e paditur. Nga natyra e mesiperme e pavlefshmerise absolute rrjedhin edhe nje sere pasojash te tjera ku akti administrativ absolutisht i pavlefshem nuk mund te behet i vlefshem me asnje veprim te mevonshem, qofte ky edhe pelqim ose miratim i paleve pjesemarrese ne te.

## **GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT**

Pasi degjoi relatimin e gjyqtarit Artur Malaj ne dhome keshillimi:

### **VEREN**

Paditesi Shoqeria“ Joela Cuko” Sh.p.k, ka deklaruar ne blerje per vitin 2012 sipas Faturave me nr. serie 87320241, 87320243, 87320244, 873202245, 87320246, 87320247 87320248, 87320249, 87320250, 01331812, 01331813, 01331801 perkatesisht ne dt 5.03.2012; 9.03.2012; 10.03.2012; 12.03.2012; 12.03.2012; 13.03.2012; 14.03.2012; 17.03.2012; 19.03.2012; 20.03.2012; 28.04.2012; 28.04.2012; 21.03.2012.

Ne dosjen gjyqesore administruar edhe kopjet e ketyre faturave te shitura nga shoqeria "DIELLI I.I.B"shpk me NIPT LI8002201M.

Rezulton se mbi bazen e verifikimit nga DPT Tirane rezulton se subjekti "DIELLI I.I.B" shpk me NIPT L 18002201 M nuk ka shitur ne te vertete mallra sipas faturave te siper permendura pasi ka qene vetem nje shoqeria fantazem. Per ekte shkak per kete shoqeri ka filluar edhe procedimi penal.

Referuar shkreses me nr. 10205/3 prot dt 17.05.2013 te DPT Tirane dhe Drejtorise se Hetimit Tatimor rezulton se subjekti "DIELLI I.I.B" shpk me NIPT L18002201M nuk ka ushtruar aktivitet por eshte marre vetem me leshimin e faturave fiktive. Kjo shkrese eshte administruar si prove nga gjykata.

Nga kontrolli i ushtruar nga DRT Fier ne baze te lajmerim kontrollit nr.7278 date 26.06.2013 u konstatua se subjekti " Joela Cuko " sh.p.k ka kryer blerje nga subjekti "DIELLI I.I.B shpk dhe per pasoje ka kreditur ne menyre te paligjshme t.v.sh e ketyre blerjeve fiktive.

Pervec ketyre Raport -Kontrollit -Perfundimtar te administruar si prove shkresore eshte vendosur qe blerjet e kryera te mos njihen dhe per pasoje edhe TVSH-ja e kredituar nga keto blerje te zbritet duke bere Rivlersim Tatimor per blerje fiktive .

Bazuar ne sa me siper pala e paditur ka nxjerre aktin administrativ njoftim vleresimi tatimore nr.7278/5 prot dt.29.08.2013, i cili ne total ( detyrim tatimor, gjobe, kamatvonesa ) permban detyrimin e pales paditese ne Shumen 3.666.870 leke.

Kunder ketij vendimi ka paraqitur ankim pala paditese ne Drejtorine e Apelimit Tatimor. Kjo e fundit me vendimin nr.17099/1 dt.15.11.2013 ka vendosur te refuzoje ankimin e paditesit , si te paparanueshem , me argumentin se nuk eshte kryer pagesa e detyrimit tatimore, pasi sipas nenit 107 te Ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 " Per procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise " , tatimpaguesi per te bere ankim administrativ, bashke me ankesen duhet te paguaje shumen e plote te detyrimit, ( pa gjobat ) te percaktuar ne njoftimin e vleresimit te administrates tatimore.

Ne keto kushte paditesi i eshte drejtuar gjykates me padine objekt gjykimi duke kerkuar pavlefshmerine absolute ( jo relative ) te aktit administrative " njoftim vleresimi per detyrimet tatimore" numer prot 7278/5 date 29.08.2013 , lene ne fuqi me Vendimin e Drejtorise se Apelimit Tatimor nr. 17099/1 Prot. date 15.11.2013 duke shfuqizuar kete akt dhe duke zgjidhur pasojat, anulimin e gjobes.

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore e ka rrezuar padine si te pabazuar ne ligj. Gjykata Administrative e Apelit cmon se ky vendim eshte I bazuar ne prova dhe ne ligj dhe se nuk ka shkaqe ligjore per pranimin e ankimit, per arsyet e meposhtme:

Se pari: Paditesi e ka bazuar padine e vet nder te tjera edhe ne nenet 324, 329, 331 te K.Pr.Civile qe bejne fjale per kundershkrimin e aktit administrativ. Padia eshte paraqitur ne Gjykatën Administrative te Shkalles se Pare Vlore, ne dt.04.12.2013.

Gjykata Administrative e Apelit cmon se ne nenin 72 te Ligjit nr.49/2012 “ Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative “, parashikohet:

“ Ne daten e fillimit te funksionimit te gjykatave administrative hyjne ne fuqi ndryshimet e meposhtme:

a) Ne ligjin nr.8116, dt.29.03.1996 “ Kodi i Procedures Civile I Republikes se Shqiperise, I ndryshuar:

iii) nenet 324 deri 333 shfuqizohen. “.

Ne dt.04.11.2013 ne baze te Dekretit te Presidentit te Republikes filluan funksionin gjykatat administrative, cka do te thote se qysh nga kjo date dispozitat ligjore proceduriale ku paditesi ka bazuar padine e vet per kundershkrimin e aktit administrative kane qene shfuqizuar. Pra padia eshte pa baze ligjore.

Se dyti: Paditesi ka kerkuar pavlefshmerine absolute te aktit administrativ “ njoftim vleresimi per detyrimet tatimore" nr prot nr.7278/5 date 29.08.2013 , lene ne fuqi me Vendimin e Drejtorise se Apelimit Tatimor nr. 17099/1 Prot. date 15.11.2013 duke shfuqizuar kete akt dhe duke zgjidhur pasojat, anulimin e gjobes.

Ne lidhje me kete kerkim Gjykata Administrative e Apelit cmon se ky kerkim eshte i pabazuar per arsyet e meposhtme:

Paditesi ka keqinterpretuar ligjin persa i perket konstatimit te akteve si absolutisht te pavlefshme. Qe akti administrativ te quhet absolutisht i pavlefshem ne kuptim te nenit 115 duhet te jete ne kundersizim flagrant me ligjin dhe ne kuptim te nenit 116 te Kodit te Procedurave Administrative duhet te plotesoje 3 kushte:

Se Pari : kur akti eshte nxjerre nga nje organ administrativ i painedifikuar:

Akti objekt padie, " njoftim vleresimi per detyrimet tatimore" nr prot nr.7278/5 date 29.08.2013 eshte nxjerre nga Drejtoria Rajonele Tatimeve Fier, e cila eshte organ i administrates publike, me adrese dhe vendodhje te sakte dhe te percaktuar ne baze te ligjit dhe akteve nenligjore ne fuqi.

Se dyti : kur akti eshte nxjerre nga nje organ administrativ ne kapercim te kompetencave te tij ligjore: Organi administrativ Drejtoria Rajonele Tatimeve Fier, e ka nxjerre kete vendim ne perputhje te plote me ligjin organik, nr.9920, date 19.05.2008, "Per procedurat tatimore ne Republikën e Shqiperise.

Se treti: kur akti eshte nxjerre ne kundersizim me formen dhe proceduren e kerkuar nga ligji: Akti administrativ eshte nxjerre ne formen dhe proceduren e kerkuar nga ligji, pasi ai ka te shprehur sakte pjesen hyrese, pjesen sqaruese si dhe dhe ate urdheruese ose vendimmarrese ne perputhje me ligjin dhe aktet nenligjore ne fuqi.

Akti administrativ objekt ankimi " njoftim vleresimi per detyrimet tatimore" nr prot nr.7278/5 date 29.08.2013 eshte nxjerre nga Drejtoria Rajonele Tatimeve Fier, eshte nxjerre nga nje organ i identifikuar, i cili ne marrjen e vendimit ka vepruar ne perputhje te plote me kompetencat qe i jane akorduar ketij organi nga ligji dhe ne perputhje me formen dhe procedren e kerkuar nga ligji specifik.

Nisur nga sa me lart, nuk jemi perpara asnje prej rasteve qe ka parashikuar Kodi i Procedures Administrative ne nenin 116, per te kerkuar pavlefshmerine absolute te nje akti administrativ. Per kete shkak, nuk ka asnje arsytim ligjor ne lidhje me pretendimin se " njoftim vleresimi per detyrimet tatimore" nr prot nr.7278/5 date 29.08.2013 eshte nje akt absolutisht i pavlefshem.

Kodi i Procedures Administrative ne nenin 115, shprehet se, aktet administrative te nxjerra ne kundersizim flagrant me ligjin jane absolutisht te pavlefshme, ndersa ato te nxjerra ne kundersizim

me ligjin jane relativisht te pavlefshme. Pra, nga nje interpretim literal i dispozites kuptohet se dallimi midis ketyre dy llojeve te pavlefshmerise qendron ne shkallen e shkeljes se ligjit, gje per te cilen nuk eshte dhene asnje arsytim ligjor nga ana e shoqerise. Perkundrazi, pala paditese pretendon se vendimi i ankimuar eshte nje akt i nxjerre ne kundersizim me ligjin dhe me provat qe gjenden ne dosje gjyqesore, pra nuk shprehet se eshte ne kundersizim flagrant me ligjin per te pretenduar me pas pavlefshmerine absolute.

Nga ana e pales se Paditur eshte vepruar ne perputhje te plote me ligjin specifik, dhe konkretisht me Ligjin nr 9920 dt 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne R.Sh" neni 72 prashikon:

*“ Mënyrat alternative të vlerësimit nuk kufizohen, por bazohen në:*

*a) të dhëna të drejtpërdrejta, që gjenden në deklaratat tatimore ose në dokumentet apo në një informacion tjetër, dhënë nga tatimpaguesi;*

*b) të dhëna të drejtpërdrejta, dokumente ose informacion, dhënë nga palë të treta;*

*c) krahasime me një veprimtari ekonomike të ngjashme, të kryer nga tatimpagues të tjerë;*

*ç) të dhëna të tërthorta, bazuar në çmimet e tregut të mallrave dhe shërbimeve të ngjashme, si dhe të pagave krahasuese;*

*d) çmimet e referencës së shitjeve me pakicë, kur tatimpaguesit e TVSH-së nuk lëshojnë ose nuk mbajnë fatura tatimore.*

*2. Kur vlerësohet detyrimi tatimor, që lind nga transaksione ndërmjet personave të lidhur, mënyra alternative e përdorur pasqyron të ardhurat e tatueshme, që do të kishin rezultuar nga transaksione të krahasueshme, ndërmjet personave të palidhur.*

*3. Rregullat për zbatimin e këtij neni përcaktohen në udhëzimin e Ministrisë së Financave, të nxjerrë në zbatim të këtij ligji.”*

Nga te gjitha provat shkresore vertetohet se Administratori i subjektit "DIELLI I.I.B" shpk jo vetem qe nuk ka shitur Lende Drusore por nuk ka patur asnje blerje nga ana e tij ne Artikullin Lende drusore. Pikerisht per kete eshte marre si i pandehur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Kukes me akuzen per evazion Fiskal ne shumen 168.745.082 leke te reja TVSH qe ka rezultuar nga kqyrja e Sistemit Informatik Tatimor .

Bazur ne te gjithe kontrollin e bere nga ana e inspektorit mbi kete subjekt eshte vendosur ne menyre te drejte dhe te bazuar plotesisht ne ligj i gjithe detyrimi i dale nga njoftim vleresimi.

Per rrjedhoje Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore ka cmuar drejt kur ka aritur ne perfundimin se duhet te rrezoje padine si te pabazuar ne prova dhe ne ligj dhe te pranoje si plotesisht te bazuara pretendimet e pales se paditur.

### **PER KETO ARSYE**


Gjykata Administrative e Apelit , bazuar ne nenin 50/1/b te Ligjit nr.49/2012 “ Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative “

### **VENDOSI**

- Lenien ne fuqi te Vendimit te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Vlore nr. 80 , date 03.02.2014
- Kunder ketij vendimi palet mund te paraqesin rekurs ne Gjykatën e Larte, Kolegji Administrativ.
- U shpall, sot me date 12.05.2014 ne Tirane.


**ANETARE**

**LINDITA SINANAJ**



**ANETARE**

**ALTINA NASUFI**



**KRYESUES**

**ARTUR MALAJ**

